

PERSONALITET - SINTEZË E IDEALIT TË NJOHJES ME IDEALIN HUMANIST PËR BOTËN

Arben HOXHA
Instituti Albanologjik
Prishtinë

Hyrje

Pesëmbëdhjetë vjetori i vdekjes së një prej kolegëve tanë më të nderuar, Sefedin Fetiut, bashkëpunëtorit të lartë shkencor të Institutit Albanologjik, është më kuptimplotë kur atë e shënojmë duke e kujtuar dhe vlerësuar veprimtarinë shkencore dhe letrare, pra punën e tij. Pse? Realizimi i qenies sonë është i kushtëzuar nga veprimtaria jonë në botë. Puna i paraprin qenies sonë. Puna përbën një kategori ontologjike, me anë të së cilës njeriu e strukturon veten në botë dhe vihet në aksion për ta strukturuar botën sipas qëllimeve të vetëdijshme të tij.

Puna ishte vendi i ekzistencës së Sefedin Fetiut, ndërsa 15-të vjetori i vdekjes së tij përbën një moment të aktualizimit të saj. Në këtë përvjetor të 15-të të vdekjes ne shohim se njohja dhe të vepruarit për botëkuptimin jetësor të Sefedin Fetiut ishin të pa ndara. Në rezultatet e punës së Sefedin Fetiut, e gjejmë, siç do të thoshte Gadameri, vetëdijen aktive historike, e cila si vetëdije esencialisht është në mundësinë që të ngrihet mbi atë që ajo është¹, pra, në rastin tonë, mbi vetëdijen për letërsinë dhe shkencën letrare. Në rezultatet e punës së Sefedin Fetiut e gjejmë të strukturuar: idealin e kërkimit dhe mundësitë e shtrirjes së të njohurit letrar dhe për letërsinë;

¹ Hans Georg Gadamer, *Istina i metoda: osnovi filozofske hermeneutike*, IP "Veselin Maslesa", Sarajevo, 1978, f. 376.

qëllimet etike dhe etikën e qëllimeve tij në punë të përsosmërisë dhe humanizimit të vetes dhe mjedisit që e rrethonte; si dhe përmbajtjen e vetëdijes që ai ka pasur për veten dhe botën.

Parë në këtë kontekst, shënimi i përvjetorit të 15-të të vdekjes së Sefedin Fetiut nuk ka karakter lamenti, por vjen si një moment për testimin dhe verifikimin e qëndrueshmërisë së të vërtetave letrare e shkencore të shqiptuara dje prej tij përballë gjendjes së kulturës tonë letrare sot.

Dy trajtat e veprimtarisë

Qenien e Sefedin Fetiut (qenien këtu e përdorim si koncept që përfshin gjithë botën e gjërave të veçanta shpirtërore dhe, njëkohësisht, të gjitha konceptet e llojit që lidhen me këto botë) mund ta interpretojmë, analizojmë dhe vlerësojmë duke e kundruar atë përmes dy trajtave të veprimtarive: përmes trajtës së veprimtarisë që drejtohet nga arsyeja praktike dhe përmes trajtës së veprimtarisë që drejtohet nga arsyeja teorike. Hulumtimi i arsye së parë na drejton në të njohurit e sferës kombëtare të qenies së Sefedin Fetiut, ndërsa hulumtimi i arsyes së dytë na drejton në të njohurit e sferës njerëzore të qenies së tij.

Nëse themi se liria kombëtare është koncept-produkt i arsyes praktike dhe ka karakter historik, liria ekzistenciale është koncept-produkt i arsyes teorike dhe ka karakter metahistorik. E para do të shfaqet në aktin e përfshirjes së Sefedin Fetiut në organizatën politike Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, të udhëhequr nga Adem Demaçi, dhe në aksionin për ngritjen e flamujve kombëtarë në Gjakovë. Ndërsa, e dyta do të shfaqet në veprat shkencore e letrare të tij. Sefedin Fetiut arsyen teorike do ta vërë në funksion të zgjerimit të kufijve veprues të arsyes praktike.

Etika e qëllimeve politike e jetësore, që buron prej arsyes praktike, me qëllim të zotërimit praktik të realitetit, dhe etika e qëllimeve shkencore e letrare, që buron prej arsyes teorike, natyrshëm do ta gjejnë unitetin e tyre në idealin e humanizmit liberal të Sefedin Fetiut për lirinë ekzistenciale, si instancë më e lartë e emancipimit të njeriut në raport me natyrën, me shoqërinë, me botën dhe me vetveten. Në filozofinë politike e jetësore të Sefedin Fetiut, liria kombëtare do të jetë kusht i lirisë ekzistenciale dhe në funksion të saj. Liria ekzistenciale për Sefedin Fetiut do të jetë masa supreme e vetëdërgjegjësimit, e kuptimit dhe e vlerës për vetëçlirim dhe emancipim të njeriut në mjedisin ku jeton dhe vepron.

Dy kategoritë themelore

Në veprimtarinë e Sefedin Fetiut janë dy kategori themelore njohëse, të cilat do ta përcaktojnë marrëdhënien e tij me lirinë ekzistenciale: kategoria e të vërtetës dhe e kuptimit. E vërteta dhe kuptimi për Sefedin Fetiun përfaqësojnë thelbin e të *qenit*, ndërsa, njohja e tyre, për të do te jetë kusht për njohjen e thelbit të *qenies*. Këto kategori Sefedin Fetiut do t'i përdorë si instrumente dhe forma njohëse të “arsyes ligjëvënëse” kur ai do të ushtrojë veprimtari shkencore, dhe si instrumente dhe forma njohëse të “arsyes perceptimore” kur ai do të ushtrojë veprimtari letrare artistike.

Përcaktimi i konceptit të kuptimit dhe të kuptuarit, si përbërës të interpretimit, për Sefedin Fetiun do të jetë një nga detyrat më të qenësishme për njohjen letrare në njërin anë dhe, nga ana tjetër, ato do të përbëjnë kushtin qenësor për mundësitë reflektive dhe refleksive të qenies njerëzore në botë. Përcaktimi i raporti midis realitetit empirik të objektit letrar dhe realitetit të përjetimit të tij, të kuptimit objektiv të tekstit dhe kuptimit subjektiv të marrësit, të kriterit subjektiv dhe atij objektiv, do të përbëjë një nga detyrat e vështira epistemologjike me të cilën Sefedin Fetiut do të përballet në praktikën e vet të njohjes për letërsinë.

Që në veprën “Poetika e romanit shqiptar”, e mbrojtur si temë magjistrature në vitin 1977, kohë kjo kur te bashkësi të caktuara shkencore letrare në Kosovë *poetika* ngatërrohej me *poezinë* apo me përjetimin subjektiv të veprës letrare², Sefedin Fetiut do të ofrojë një pasqyrë të historikut të mendimeve divergjente mbi poetikën, si disiplinë e studimit të veprës letrare. Nga perspektiva e sotme ky fakt nuk përbën ndonjë risi për dijet letrare. Por, prej asaj që mbetet risi edhe sot e kësaj dite është qëndrimi kritik dhe konceptimi origjinal që ai do t'i bëjë Poetikës përballë shumësisë së koncepteve divergjente për të. Subjektivitetin e vet prej studiuesi – e kjo do të thotë shfaqjen e guximit për të ndërtuar koncepte në mënyrë të pavarur dhe të pavarësuarit e tij nga ndikimet e trashëgimisë së deriatëhershme konceptuale-epistemologjike të bashkësisë shkencore që i takonte – Sefedin Fetiut do ta arrijë përmes zgjerimit të konceptit të poetikës, si instrument njohës për trajtimin e anës teknike, anës së jashtme

² Duke e ngatërruar deri në masën e shpërftyrimin me “rikrijimin” – si koncept për natyrën dhe funksionin e kritikës letrare që do ta inaugurojë Roland Barti, si një nga eksponentët e kritikës së re franceze – Sabri Hamiti Poetikën do ta konceptojë si “variant të mendimit mbi letërsinë” apo edhe “si shumë mendimesh individuale mbi letërsinë” (Shih, Sabri Hamiti: *Variante* (Sprovë për një Poetikë), “Rilindja”, Prishtinë, 1974, f. 8).

të veprës, dhe si instrument njohës për trajtimin e aspekteve estetike, morale, filozofike, politike etj., të saj.

Sefedin Fetiu, në punën e tij shkencore, *Poetikën*³ e trajton si teori dhe si mjet metodologjik nëpërmjet të cilit analizohen përbërësit që e përcaktojnë ekzistencën e të tërës së prirjeve të veçanta letrare në letërsinë shqipe. Nëpërmjet *Poetikës*, si disiplinë e cila merret me hetimin e marrëdhënieve të përbërësve të strukturës romanore, që funksionon si një sistem, Sefedin Fetiu do të përpiqet që të zotërojë ligjet e përgjithshme në bazë të të cilave funksionojnë tendencat mbizotëruese në romanin tonë.

Në procesin e kërkimit të së vërtetës, dhe kuptimit të zhvillimit të romanit shqiptar, Sefedin Fetiu do ta sinkretizojë metodën formaliste dhe atë estetike e filozofike, gjithnjë në funksion të zërthimit të strukturave të veprave romanore brenda një tipi të caktuar të romanit. Edhe pse për objekt trajtimi Sefedin Fetiu do ta ketë romanin e krijuar në letërsinë shqipe prej vitit 1952 deri në vitin 1977, megjithatë këta dy kufij kohorë nuk përmbajnë në vete idenë e parimit historicist për hulumtimin e lëndës së kërkimit shkencor. Këto dy vite në të vërtetë shënojnë kufijtë e jashtëm kohorë brenda të cilëve Sefedin Fetiu i zbulon, i përshkruan dhe i argumenton ligjshmëritë mbi bazën e të cilave zhvillohen veçoritë, prirjet mbizotëruese strukturore, kahet stiliste të romanit shqiptar. Duke e konceptuar si *strukturë*, për Sefedin Fetiu poetika – siç thotë edhe vetë – do ta ketë tretmanin e formës dhe të brendisë, të unitetit të tyre⁴. Prandaj, në studimin e tij, Sefedin Fetiu do të merret me analizën e tendencave të përgjithshme ashtu që duke i analizuar mënyrat e konstituimit të veprave të një prirjeje romanore do ta përcaktojë vlerën dhe rëndësinë e saj për perspektiven e zhvillimit të romanit tonë. Në këtë mënyrë, Sefedin Fetiu *Poetika* do t'i bëhet mbështesja e idealit të tij të njohjes shkencore për letërsinë dhe përmbushje e vizionit të tij epistemologjik për të vërtetën e zhvillimit të romanit shqiptar në të ardhmen.

Pasi e vendos kriterin për tipologjizimin e romanit tonë, Sefedin Fetiu, do ta bëjë klasifikimin tipologjizues të tij në tri grupe të mëdha: romani me prirje tradicionale, me prirje estetizuese dhe romani me prirje moderne. Prej këtij grupimi të madh ai do të krijojë edhe nëngrupime më të vogla për secilin tip të romanit. Kështu, bie fjala, në kuadër të romanit shqiptar (të prirjes tradicionale), që karakterizohet për poetikën realiste, Sefedin

³ Sefedin Fetiu, *Poetika e romanit shqiptar (1952-1977)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1992. (Kjo vepër është mbrojtur si temë magjistrature në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës më 1977).

⁴ *Po aty*, f. 14.

Fetiu do të dallojë nëngrupin e romaneve me *poetikë të reprezentimit veristik-holog* dhe nëngrupin e romaneve me *poetikë realiste të reprezentimit tipik*. Në fokus të analizës së Sefedin Fetit do të jetë, prandaj, hetimi i veçorive të mënyrës se si është realizuar përmbajtja e veprave letrare duke kaluar nëpër shtresat strukturore të saj, siç janë pozicioni i narratorit, ndërtimi i syzheut, ndërtimi i personazheve etj.

Duke përdorur metodën e deduksionit dialektik, si një nga format e njohjes dhe të kërkuarit, dhe duke i marrë për trajtim veprat reprezentative të autorëve që i takojnë grupit klasifikues të caktuar, Sefedin Fetiu, do të nxjerrë konkluzione induktive gjeneralizuese, nëpërmjet të cilave do të provohen konkludimet deduktive për strukturën e grupit dhe të tipit të caktuar të romanit shqiptar.

Më poshtë po sjellim një shembull se si ky studiues e bën analizën e veçorive strukturore të romaneve me poetikë të reprezentimit veristik-holog:

“Në romanet e grupit të parë vërehet distanca e zvogëluar e pozicionit të narratorit ndaj elementeve të tjera të strukturës. Ke përshtypjen se thurja e veprimit, gërshetimi i të ndodhurave, ndërtimi i personazheve; organizimi i materies në përgjithësi buron më tepër nga kujtimet, shënimet, dokumentet, ditarët, kronikat, me të cilat janë shërbyer autorët, se sa nga trillimi i situatave, riprodhimi apo rikrijimi i momenteve në mënyrë imagjinatave. Është e qartë se fikcioni ka bërë punën e vetë në këto vepra, por nuk mund të mohohet se ai është nën pushtetin dhe dominimin e faktografisë. Pikërisht për këtë, disa nga këto vepra vuajnë nga proliksiteti, nga grumbullimi i tepruar i episodeve, skenave, pamjeve të njëjta, që nuk sjellin asgjë të re apo tipike.”⁵

E vërteta dhe kuptimi në veprën e tij studimore “Poetik e romanit shqiptar..” do të përdoren si kategori epistemologjike e interpretimit, ndërsa këto kategori në veprën “Migjeni” do t’iu nënvendosen koncepteve, të cilat përfshijnë edhe kushtet e ekzistencës njerëzore. Në rastin e parë përmes poetikës, si disiplinë e studimit letrar, vepra letrare do të trajtohet si objekt-subjekt, ndërsa, në rastin e dytë, vepra letrare do të trajtohet si subjekt-objekt.

Në rrafshin metodologjik, zgjidhjen e problemeve të reja për shkencën letrare shqiptare, Sefedin Fetiu do ta kërkojë përmes gërshetimit të hermeneutikës fenomenologjike, e cila përqendrohet në përjetimin sub-

⁵Sefedin Fetiu, *Poetika e romanit shqiptar (1952-1977)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1992, f. 30-31.

jektiv të vetëdijes së marrësit, dhe strukturalizmit, i cili përqendrohet në strukturën objektive të veprës letrare. Mund të themi se kjo mënyrë e trajtimit të fenomeneve, të proceseve dhe veprave letrare nuk përbën një paradigmë në vetë, por një nga modelet origjinale, më vitale e më moderne nga shumësia e modeleve brenda paradigmës integrale të përdorura në praktikën e shkencës sonë letrare.

Një mënyrë e tillë e të konceptuarit të poetikës, si instrument epistemologjik për zotërimin e të vërtetës dhe kuptimit, nuk do të ishte e mundur pa revolucionarizimin që do t'i bëjë shkencës letrare shqiptare paradigma integrale. E themeluar nga Rexhep Qosja, paradigma integrale në shkencës letrare, që në fund të viteve 60-të të shekullit të kaluar, do të ofrojë zgjidhje më bindëse dhe shkencërisht më të argumentuara për problemet e njohura të prejardhura nga trashëgimia e paradigmat së historizimit dhe sociologjizimit vulgar. Paradigma integrale përpos përgjigjeve shumë bindëse që do t'u japë problemeve tashmë të njohura, ajo do të përmbajë kushtin e problemeve që kërkojnë zgjidhjen e tyre në një proces të vazhdueshëm njohës. Puna hulumtuese shkencore e Sefedin Fetiut buron nga kjo sferë e qenies së paradigmat integrale: nga sfera e problemeve të reja të shfaqura që kërkojnë përgjigje adekuate, të qëndrueshme dhe të vlefshme.

“Pro” pluralizmit epistemologjik / “kundër” relativizmit logjik

Problemet e reja njohëse presupuzojnë krijimin e një hapësire të re konceptimi të marrëdhënies së subjektit njohës me lëndën si subjekt i hulumtimit. Pse? Sepse problemet e hulumtimit e përcaktojnë lëndën e hulumtimit, ndërkaq lënda e hulumtimit për zotërimin e saj nga subjekti njohës, imponon koncepte të caktuara për të vërtetën, të kuptuarit si proces, dhe të vetë kuptimit.

Kriterin e formulimit të problemit shkencor për romanin shqiptar Sefedin Fetiut do ta bazojë në hipotezën që buron nga nevoja e zgjerimit të njohjes duke i zotëruar mungesat e njohës shkencore të deriatëhershme për këtë lloj arti letrar. Ndërkaq, kriterin e formulimit të problemit shkencor për veprën letrare të Migjenit⁶, Sefedin Fetiut do ta ndërtojë mbi hipotezën që buron nga nevoja për verifikim e njohjes aktuale shkencore përballë njohjes së kaluar për dhe rreth veprës së këtij autori. Këto dy burime të

⁶ Dr. Sefedin Fetiut, *Vepra e Migjenit dhe kritika e saj*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1984.

hipotezave do ta përcaktojnë aktualitetin dhe rëndësinë e problemit, ndërsa zgjidhja e tij – mundësitë e mendimit shkencor letrar shqiptar për t'i kaluar kufijtë e tij ekzistues njohës.

Në qoftë se qëllimi i mendimit pozitivist shkencor shqiptar për romanin shqiptar, në një rën anë dhe, nga ana tjetër, për veprën letrare të Migjenit, do të përcaktohet mbizotërueshëm prej metodës logjike shpjeguese, e cila bazohet në pyetjen “pse?” një fenomen, një ide, një temë ekziston; ndërkaq, qëllimi i mendimit shkencor i Sefedin Fetiut do të përcaktohet prej metodës logjike të arsytimit, e cila bazohet në gjetjen e arsyeve (kuptimit) se pse një fenomen, një ide, një temë, një mënyrë e caktuar e trajtimit ka vlerë ose jo. Në rastin e parë, lëndë e shpjegimit në mendimin shkencor letrar do të jenë faktet e veçanta apo një grumbull faktesh; ndërsa, në rastin e dytë, lëndë e arsytimit do të jenë ligjet e përgjithshme, që e përcaktojnë ekzistencën dhe zhvillimin e atyre fakteve, me ç'rast një fenomen, një strukturë, një ide, në temë, një mënyrë e caktuar e trajtimit shikohet si pjesë integrale e fenomeneve, e strukturave, e ideve etj., të shfaqura më herët dhe atyre që do të shfaqen në të ardhmen.

Në veprën shkencore të Sefedin Fetiut, të kuptuarit konceptohet si “fushë” ku shpërfaqet fuqia vepruese e racionalitetit dhe e objektivitetit të arsyes njerëzore. Ndërsa krijimtarinë letrare imagjinative ai do ta konceptojë si “sferë të së vërtetës së zbuluar” (Hajdegeri) përmes së cilës bota vjen te njeriu, e cila ia zbulon qenin dhe kuptimin për të. E vërteta e tillë, që buron nga pikëpamja e ekzistencializmit fenomenologjik për botën, mëshirimin e vet do ta gjejë në romanin “Në humbëtirat e kohës”, ku historia, periudha e Lidhjes së Prizreni, është sfondi kohor në të cilën vendoset individi, i cili veten e sheh si objekt të mendimit të vet në përpjekjen e tij për të qenë vetvetja.

Marrë në tërësi, në veprën studimore dhe letrare të Sefedin Fetiut kuptimi, interpretimi dhe e vërteta, në ndërlidhjen e tyre reciproke, konceptohen jo vetëm si çështje të pastra epistemologjike, por si fenomene që i takojnë përvojës së tërësishme të botës njerëzore. Bazuar në këtë koncept është krejtësisht e natyrshme që Sefedin Fetiut të jetë kundërshtar i pikëpamjes moniste për njohjen, sipas së cilës karakteristikat e një fenomeni janë përbërësit e natyrës së tij. Sefedin Fetiut asnjëherë nuk do të bëhet viktimë e “mashtimit optik” të një logjike të tillë njohëse. Por ai, gjithashtu, nuk do të jetë ithtar i verbët i pluralitetit epistemologjik.

Dr. Sefedin Fetiut në shkencën letrare do të jetë ithtar i tolerancës dhe mirëkuptimit ndaj metodave dhe teorive të ndryshme, por do të jetë kundërshtar i ashpër kundër jotolerancës, që prodhon relativizmi logjik, sipas

së cilës të gjitha tezat janë të përligjura dhe të barasvlershme në njohje. Ai, në njërën anë, do të jetë ithtar i konceptcionit poperian që bie ndesh me tolerancën e shthurur që e prodhon relativizmi dhe, nga ana tjetër, do të jetë mbështetës i flakët i pluralizmit kritik.

Pse? Sepse për konceptin që Sefedin Feti u ka për të vërtetën, toleranca - si hapësirë e barasvlershme kognitive për të gjitha tipat dhe llojet e të vërtetave duke mos marrë parasysh rëndësinë e vlerës së tyre - çon te kaosi gnoseologjik e aksiologjik. Ndërkaq, pluralizmi kritik, si botëkuptim dhe si etos epistemologjik, e mundëson hierarkizimin e të vërtetave sipas vlerës dhe funksionit që ato kanë në procesin e zgjerimit të kufijve të njohjes sonë për botën.

Etika e tillë epistemologjike dje u bënte ballë veseve të ulëta epistemologjike të pseudoshkencës letrare shqiptare. Sot, një etikë e tillë ka nevojë për aksionin tonë për ta rifunksionalizuar atë.

Veprimtaria shkencore e letrare e Sefedin Fetiut përbën një gjenerator për ndjenjën e detyrës që duhet të kemi përballë një aksioni të tillë.

Përfundim

Në kontekstin e një botë që lëngon nga mungesa e autoritetit të së vërtetës; ku e vërteta dhe kuptimi nuk trajtohen si subjekt i njohjes; ku si pasojë e rrënimit të idealit për të vërtetën, për të kuptuarit dhe idesë së vlefshmërisë së tyre në njohje, si çështje thelbësore të realitetit të qenies njerëzore; kur në emër lirisë së mendimit, të lirisë së përdorimit të metodave, në emër të së resë, shkenca jonë letrare është futur në një kaos më të thellë se në kohën kur Sefedin Feti u, bashkë me mendimtarët e tjerë, zhvillonte beteja intelektuale e profesionale për të vërtetën, veprimtaria e tij shkencore e letrare sot na vjen më provokuese në ftesë për t'u përfshirë në aksionin e kthimit të dinjitetit të së vërtetës dhe të shkencës letrare shqiptare aq keq të nëpërkëmbur nga pseudoshkenca dhe nga mbështetësit e saj sot.

